

Editorial/

ISLAMI DHE LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT

Deklarata e mbylljes së Konferencës Ndërkombëtare Islame



Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve. Mëshira dhe bekimet e Tij qofshin mbi të Dërguarin si mëshirë për mbarë njerëzimin, Muhamedin (alejhissalatu usselam), mbi familjen dhe të gjithë shokët e vet!

Në vendin e zbritjes së shpalljes, aty ku nisi mesazhi hyjnor, në Mekën e nderuar, u mblohdhën tok dijetarët dhe mendimtarët e umetit islam, të ardhur nga kontinente të ndryshme, duke iu përgjigjur ftesës së Ligës së Botës Islame për të zhvilluar konferencën mbarë islame, "Islami dhe lufta kundër terrorizmit". Kjo konferencë u zhvillua nën kujdesin e shërbëtorit të dy xhamive të shenjta, mbretit Selman ibn Abdulaziz es-Saud, për të gjetur përkufizimin e duhur të terrorizmit dhe për të diagnostikuar shkaqet e tij. E gjithë kjo bëhet për ta mbrojtur umetin islam nga ndikimet e terrorizmit, dhe për të gjetur mënyrat e shpëtimit, pasi ai ka zënë vend, dhe është rritur rreziku i tij, aq sa e ka shpërfytyruar pamjen e fesë islame duke përligjur derdhjen e gjakut të pafajshëm dhe duke thelluar ndasitë doktrinale, etnike dhe fetare. Për këtë arsye, armiqtë e Islamit janë shfaqur më shumë se kurrë duke synuar cenimin e identitetit islam, unitetit dhe burimet e tij.

Përballë këtij rreziku vrastar, dijetarët pjesëmarrës në konferencë përcjellin këtë deklaratë, që përmban pesë mesazhe, të cilat konferenca ua drejton udhëheqësve të umetit islam, dijetarëve, mjeteve të informimit, rinisë islame, dhe mbarë qeverive e popujve të botës, duke kryer detyrimin për të

qenë transparentë, për të parashtruar argumentet e duhura, dhe duke u justifikuar te Zoti. Kjo mbështetet kryesisht në hadithin profetik ku thuhet: "Feja është të qenit i kulluar, i sinqertë dhe transparent." E pyetën: Me kë të jemi të tillë o i Dërguari i Allahut? Ai tha: "Me Allahun, me Librin e Tij, me të Dërguarin e Tij, me prijësit e muslimanëve dhe me masën e gjerë."

Mesazhi i parë

Ftesa e udhëheqësve të umetit te:

- Puna e vendosur për të gjykuar me sheriatin islam, reformat gjithëpërfshirëse për të arritur drejtësinë, ruajtjen e dinjitetit njerëzor, përkujdesin për të drejtat e njeriut, përgjigjen e kërkesave të popullit, realizimin e një jete të mirë, dhe përmbushja e kërkesave për një qeverisje të mirë.

- Ruajtja e unitetit të muslimanëve, përballja me përpjekjet për përçarje të umetit në aspektin doktrinal, etnik dhe fetar, dhe forcimi i solidaritetit islam në të gjitha format e mundshme.

- Shfrytëzimi i shkaqeve që çojnë në arritjen e forcës materiale dhe morale, përmirësimi i përdorimit të burimeve njerëzore dhe natyrore, dhe integrimi i vendeve islame mes tyre.

- Rishikimi i programeve arsimore dhe edukuese, dhe i mënyrës së ligjërimit fetar, për të arritur në një rrugë të mesme.

- Zgjidhja e konflikteve në shoqëritë islame sipas librit të Allahut, traditës profetike, dhe rrugës që ndoqën të parët e këtij umeti, nëpërmjet themelimit të Gjykatës Islame të Drejtësisë, dhe largimi i bijve të këtij umeti nga çrregullimet dhe vëllavrasja, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre doktrinale dhe sektare.

- Krijimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për t'u mbyllur rrugën burimeve të terrorizmit, dhe rritja e besueshmërisë mes umetit islam e prijësve të tyre për të mbështetur çështjet publike, për të luftuar korrupsionin, për të kufizuar varfërinë dhe papunësinë, dhe për t'u kujdesur më shumë për të drejtat qytetare të të gjithë pjesëve përbërëse të shoqërisë.

- Mbështetja e pakicave islame në ruajtjen e identitetit të tyre, në mbrojtje të interesave për të rritur më shumë kapacitetet, dhe për t'u dhënë mundësinë ta përçojnë mesazhin e tyre e të kryejnë gjithashtu detyrat që kanë karshi shoqërive ku jetojnë, duke qenë të mesëm në teori dhe praktikë.

Mesazhi i dytë

Ftesa e dijetarëve të umetit te:

- Ruajtja e identitetit të umetit islam, angazhimi për ndërgjegjësim në mbrojtje të fesë dhe për të qenë të sinqertë me të gjithë, e të vetëdijshëm në përcjelljen e mesazhit dhe ngritjes së tij në nivelin e duhur.

- Arritja e qëllimit për të qenë shëmbëlltë të mirë, dhe kryerja e detyrës për të qenë të sinqertë,

(Vijon në faqen 4...)

Fq. 2/ Pyetje - përgjigje

..... përgatiti: Lidhja e Hoqxhallarëve të Shqipërisë

Fq. 5/ Ateistët e rinj, vendparkimi dhe një vrasje

..... nga Ibrahim Kallën

Fq. 6/ Prindërit myslimanë dhe arsimimi

..... nga Mahasin D. Shamsid-Deen

Fq. 7/ Islami është pjesë e pandarë e Europës

..... përgatiti: Emërim Koçi

PYETJE - PËRGGJIGJE

Fetva për gazetën

Subjekti:

Zhvillimi i Qytetërimit Islam

Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam

Me Emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

Lavdërimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Paqja dhe bekimi qoftë për zotërinë tonë, Muhamedin, vulën e profetëve, për familjen e për mbarë shokët e tij!

Vendimi nr. 163 (1/18)

Rreth subjektit: Shenjat orientuese në rrugën drejt kthimit të qytetërimit islam

Asambleja e Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut Islam, e dalë nga Organizata e Konferencës Islamike, e mbledhur në sesionin e saj të tetëmbëdhjetë në Putraxhaja (Malajzi) nga data 24-29 xhumadil ahir të vitit 1428 h./9-14 korrik 2007 e.r., pasi mori në shqyrtim studimet e paraqitura pranë Akademisë në lidhje me temën "Shenjat orientuese në rrugën drejt kthimit të qytetërimit islam", pasi dëgjoi diskutimet që u zhvilluan rreth kësaj teme, pasi riktheu edhe njëherë në kujtesë pararendjen e Islamit në themelimin e shtetit të së drejtës, ku Profeti i madh i Islamit

vendosi Dokumentin e Medinës, dokument ky që përcaktonte marrëdhëniet në shoqërinë e parë islame, pasi risolli në vëmendje edhe shpalljen botërisht nga ana e Profetit të të drejtave të njeriut në Hutben e tij të Lamtumirës, si dhe duke u bazuar në dritën e teksteve kur'anore dhe ato profetike, që janë kushtetuta islame, siç është fjala e Allahut të Lartësuar: "Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën" (Surja en-Nahl, ajeti 90), "O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja" (Surja en-Nisa, ajeti 59), vendosi si më poshtë:

Së pari: Duhet të ecet në rrugën e ngritjes së qytetërimit islam, sepse kjo u jep myslimanëve mundësinë ta rikthejnë rolin e tyre historik dhe të paraqesin mesazhin human që mbartin, për ta shpëtuar botën nga errësirat e tiranisë materialiste.

Së dyti: Rrugua e kurimit të prapambetjes, nga e cila vuan umeti islam, duhet jetë kthimi i sinqertë të feja e drejtë, sepse gjendja e rëndë në të cilën jetojnë myslimanët vjen për shkak të braktisjes së mësimëve islame dhe imitimit të sistemeve pozitiviste.

Së treti: Qasja islame ndaj qytetërimit ngrihet mbi një plan të qartë e të konsoliduar, dhe që i

çliron shoqëritë e vendet islame nga dominimi, varësia e prapambetja.

Së katërti: Të kuptuarit mirë të Islamit, serioziteti në vënien në zbatim të dispozitave të tij, zbatimi i plotë dhe i ekuilibruar i tij, janë një domosdoshmëri për suksesin e projektit të rilindjes islame.

Së pesti: Duhet të konsolidohet parimi i Shuras, në aspektin teorik dhe atë praktik, duke vënë kështu në zbatim fjalën e Allahut të Madhëruar, "dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme" (Surja Ali Imran, ajeti 159), "dhe këshillohen për punët e veta me njëri-tjetrin" (Surja esh-Shura, ajeti 38), si dhe duke u nisur nga fakti se Shura është një nga themelet e forta mbi të cilat ndërtohet shteti i Islamit.

Së gjashti: Legjitimiteti i ndarjes ndërmjet pushteteve: pushteti ekzekutiv, legjislativ dhe ai gjyqësor, ashtu siç janë stabilizuar pas epokës së shpalljes hyjnore ligjore, dhe kjo duke u mbështetur tek praktika e Profetit (alejhi salatu ue selam) në veprimtarinë e tij të larmishme ndërmjet të qenit sjellës i mesazhit hyjnor, burrë shteti dhe gjykatës.

Së shtati: Njohja e së drejtës së shtetësisë, duke përfshirë këtu edhe jomyslimanët, në përputhje me rregullat ligjore islame të reciprocitetit ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve.

Së teti: Pjesëmarrja e gruas në aktivitetet publike, për aq sa nuk cenohen dispozitat e veçanta të ligjit islam për të, "**Besimtarët dhe besimtarët janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira, dhe i ndalojnë të këqijat.**" (Surja et-Teube, ajeti 71)

Së nënti: Detyrimi për të iniciuar çlirimin nga fenomenet negative në të cilat jetojnë myslimanët, në mënyrë që të bëhet e mundur kapërcimi i sfidave me të cilat ata përballen, siç janë:

- Fanatizmi medhhebor, i cili bëhet pengesë përpara lëvizjes ripërtëritëse fetare të kontrolluar e të moderuar.
- Ekstremizmi në ide dhe në sjellje, ai që shkakton probleme në shoqëri dhe nga i cilin lindin edhe lëvizjet ekstremiste.
- Ateizmi apo afetarizmi, i cili refuzon lidhjen në mes fesë dhe jetës.
- Njohja e njëanshme (e pjesëshme), që e izolon njeriun nga njohja e dimensioneve reale të çështjeve.
- Mosnjohja e vlerës së kohës, dhe pasoja që kjo lë në dështimin dhe prapambetjen e myslimanëve.

Asambleja gjithashtu sugjeron si më poshtë se:

- Hapi i parë në përpjekjet edukuese konstruktive për formimin e personalitetit të myslimanit, për rikthimin e rolit të qytetërimit islam dhe të kontributit të tij në qytetërimin njerëzor, duhet të jetë forcimi i besimit dhe shtimi i veprave të mira.
- Duhet theksuar vazhdimisht fakti se qasja islame ndaj qytetërimit ngrihet mbi konsolidimin e vlerave morale islame në shoqëri.
- Ne vlerësojmë lart rrugëtimin e shtetit malajzian për vënien në jetë të projektit të tij në ndërtimin e qytetërimit islam, si dhe ftesën për zhvillimin e një konference akademike ndërkombëtare për t'i bërë të qarta të vërtetat e qytetërimit islam dhe përmbajtjen e mesazhit të tij të përjetshëm.

Rezultatet e kësaj konference akademike duhet të shihen nga mendimtarët dhe udhëheqësit e vendeve islame.

Allahu e di më së miri!

Burimi: <http://www.fiqhacademy.org.sa/Malaysia-q18.pdf>

LSHH MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
Llogaria në lekë:
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
Llogaria në Euro:
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
Llogaria në Dollarë:
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
Tel: 0672304520 /0672538334/048320160
BKT Banka Kombëtare Tregtare
Nr. i llogarisë : 52416329

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
رابطة أئمة ألبانيا
The Albanian Imam's League

www.lidhjahoxhallareve.com
Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)
P. Egllis, Kati III, Tirana-Albania
Mob1: 00 355 672304520
Mob2: 00 355 672753789
E-mail: lidhjahoxhallareve@yahoo.com

Bordi botues:
Justinian TOPULLI
Genc PLUMBI
Mustafa TËRNIQI

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË
Unaza e Re, Rrugua: "Teodor Keko" Pallati Edglis, Tiranë-Shqipëri
lidhjahoxhallareve@yahoo.com
Tel & Fax: +355 (0)48320160
<http://www.lidhjahoxhallareve.com>

Fetva

Therja e kafshëve me ndihmën e goditjes elektrike

Asambleja e Jurisprudencës Islame
Sesioni i dhjetë, vendimi nr.4
28.02.1428 h./21.10.1987

Së pari, nëse kafsha që i hahet mishi goditet me rrymë elektrike dhe pastaj theret sipas normave islame kur ende është gjallë, atëherë mishi i saj është i lejuar me argument thënien e Allahut të Lartësuar, “Juve u janë ndaluar (t’i hani) ngordhësirat, gjaku, mishi i dërrit, ajo që theret jo në emrin e Allahut, e furnja, e mbytura, e rrëzuarja, e shpuara (nga briri i tjetrës), ajo që e ka ngrënë egërsira, përveç asaj që arrini ta thërnin (para se të ngordhë)...” (Surja el-Maide, ajeti 3)

Së dyti, nëse shpirti i kafshës së goditur me rrymë elektrike del përpara se të theret, atëherë ajo kafshë konsiderohet e ngordhur dhe nuk lejohet të hahet, me argument fjalën e Allahut të Lartësuar, “Ju është ndaluar ngordhësira...”

Së treti, goditja e kafshës me rrymë të lartë elektrike është torturë për të përpara se të theret. Islami e ndalon këtë veprim, dhe urdhëron për mëshirë dhe butësi me kafshën, sepse nga i Dërguari i Allahut a.s. përcillet se ka thënë: “Allahu ka dhënë urdhër për t’u sjellë të butë në gjithçka, prandaj nëse vrisni diçka, vriteni siç duhet, dhe nëse thërnin diçka, thërnin siç duhet. Mpriheni mirë tehun, dhe rehatojeni kafshën.” (E përcjell Muslimi)

Së katërti, nëse rryma elektrike është e ulët dhe ka goditje të lehtë, të tillë që nuk e torturon kafshën dhe realizohet për një interes të konsiderueshëm, si p.sh., për të lehtësuar dhimbjet e therjes, për të qetësuar lëvizjet e qafës dhe për t’ia zbutur rezistencën, atëherë nuk ka asnjë ndalesë nga legjislacioni islam, gjithmonë duke patur parasysh dobinë e këtij veprimi. Allahu e di më mirë!

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin, familjen dhe shokët e tij!

Falënderimet i takojnë Allahut!

Shkelja e semaforit, dhe shkeljet e tjera të trafikut

Pyetje: Shkelja e semaforit apo e rregullave të tjera të qarkullimit, si p.sh., tejkalimi i shpejtësisë brenda

dhe jashtë qyteteve, qëndrimi jo i rregullt, sidomos gjatë kohës së namazeve, dhe pengimi i të tjerëve me ose pa shkak, a është e ndaluar apo mekruh (vepër e papëlqyeshme)?

Përgjigje: Rregullat e qarkullimit janë vendosur në interes të të gjithë muslimanëve, dhe është detyrë e të tërë drejtuesve të mjeteve që t’i respektojnë ato, sepse respektimi i tyre është në interes të njerëzve, dhe shkelja e tyre bëhet shkak për aksidente dhe lëndime të të tjerëve, si dhe për shumë dëme të tjera. Ndërsa për sa i përket ndalimit para xhamisë për një kohë të shkurtër, pa shkaktuar shqetësim për të tjerët, gjë që përbën një veprim normal në traditën e njerëzve, nuk ka asgjë të keqe. Allahu e di më mirë!

Këshilli i Përhershëm i Punëve Kërkimore dhe Fetvasë në Arabisë Saudite.

Në rast mosmarrëveshjeje mes të sëmurit dhe kujdestarit të tij me mjekun, fjala e cilit prej tyre merr përparësi?

Pyetje: Nëse babai dhe i biri kanë mosmarrëveshje para mjekut për bërjen e operacionit, fjalës së kujt prej tyre i jepet përparësi?

Përgjigje: Fjalës së të sëmurit që është madhor dhe i arsyeshëm i jepet përparësi për kryerjen e një operacioni para fjalës së djalit apo babait të tij, por nëse i sëmuri nuk ka arsye dhe nuk logjikon, atëherë përparësi i jepet fjalës së babait të vet, sepse ai është kujdestari i tij.

Këshilli i Përhershëm i Punëve Kërkimore dhe Fetvasë në Arabisë Saudite.

Marrja e lejes së bashkëshortëve për ndërhyrjen cezariene, heqjen e mitrës, vezores, apo për ndërprejen e barrës

Falënderimi i takon Allahut, paqja dhe bekimet e Tij qofshin mbi të Dërguarin e Vet, Muhamedin, familjen dhe shokët e tij!
Këshilli i Dijetarëve të Mëdhenj, në sesionin e tij të 39-të, të mbajtur në Taif nga 24.02.1413 h. deri më 12.03.1413 h., mori në shqyrtim pyetjen e dërguar nga ministri i Shëndetësisë në shkresën nr. 1714439, të datës 08.01.1413 h., që i është drejtuar ministrit të Drejtësisë, dhe që me shkresën e

datës 18.01.1413 h. i është kaluar Këshillit, në lidhje me operacionet apo ndërhyrjet mjekësore, nëse është e nevojshme që për to të merret leja e bashkëshortëve, për shkak se kanë lidhje të përbashkët në këtë çështje, siç janë ndërhyrjet cezariene, heqja e mitrës, e vezores, apo ndërprerja e barrës, po qe se arsyet mjekësore për ta bërë diçka të tillë janë të pranishme, sepse ndodh ndonjëherë që gruaja është dakort për ndërhyrjen mjekësore apo kirurgjikale, ndërsa burri refuzon për një arsye të caktuar.

Këshilli e pa me vëmendje këtë pyetje, dhe iu rikthye edhe një herë vendimit të tij nr. 119, të datës 26.05.1404 h., që përmban “moslejimin e bërjes së ndërhyrjes kirurgjikale vetëm se me lejen e pacientit nëse ai është madhor, qoftë burrë apo grua, dhe nëse nuk është i arsyeshëm apo i logjikshëm, atëherë merret leja e kujdestarit të tij. Gjithashtu, Këshilli rishikoi edhe një herë vendimin nr. 140, të datës 20.06.1407 h., që lidhet me ndërprerjen e barrës nëse ka arsye të domosdoshme për ta bërë diçka të tillë.

Pas diskutimit dhe punës kërkimore, Këshilli vendosi se nëse shihet e arsyeshme nga ana mjekësore, prej autoriteteve përkatëse dhe të specializuara të besueshme, që të kryhet një ndërhyrje kirurgjikale për ndërprerjen e barrës, heqjen e vezorës, apo të një operacioni cezarian, në këtë rast merret parasysh mendimi i gruas për sa i përket dhënies apo jo të lejes për kryerjen e një ndërhyrjeje të tillë, nëse ajo është madhore (pra, e logjikshme), dhe për këtë nuk kushtëzohet leja e burrit apo e kujdestarëve të tjerë, sepse dëmi në këtë rast ka lidhje me të (gruan) në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe jo me të tjerët.

Allahu e di më mirë!

Si arriti feja islame në Uzbekistan?

Nga të dhënat historike bëhet e ditur se feja islame pati arritur në hapësirat e Republikës së Uzbekistanit atëherë kur myslimanët çliruan territoret e Perandorisë Persiane.

Sipas këtyre vlerësimeve, theksohet se njëri nga komandantët e mirënjohur të myslimanëve në kohën e emevitëve ishte edhe El Ahnef ibn Kajsi, i cili në krye të një ushtrie myslimane kishte përparuar drejt zonave të larta të lumit Xhejhun, saktësisht në vitin 30 h./650 e.r. Pastaj, në vitin 55 h./675 e.r., gjatë sundimit të shtetit emevit (41-132 h./661-750 e.r.), u çlirua në mënyrë paqësore Buharaja (qytet në Uzbekistanin e sotëm), një prej qyteteve më të rëndësishme të atyre rajoneve.

Gjendja në rajonet në fjalë u stabilizua më pas gjatë udhëheqjes së Kutejbe ibn Muslim El Bahilijut në krahinën e Horasanit, në vitin 88 h./706 e.r., pasi popullsia e atyre zonave e kishte prishur më parë marrëveshjen e lidhur me myslimanët. Dhe kështu çdo gjë ishte vënë nën kontroll, madje sundimi islam kishte shtrirë ndikimin e vet edhe në zonat përreth lumenjve Xhejhun (Amu Darya) dhe Sejhun (Syr Darya). Pastaj, më 94 h./ 712 e.r., u ndërtua xhamia e parë në Buhara, e cila çmohet akoma si një prej gjurmëve më të rëndësishme islame në këtë qytet.

Mandëj, në kohën e sundimit të kalifit më të drejtë të dinastisë emevite, Omer ibn Abdulazizit (99-101 h./717-720 e.r.), fenë islame e përqaftuan shumë prej mbretërve të territoreve përtej lumit Sejhun, madje në mënyrë vullnetare. Kurse në kohën e sundimit të shtetit abasid (132-656 h./750-1258 e.r.), gjatë udhëheqjes së kalifit El Mu'tesim (218-227 h./833-842 e.r.), Islamit e përqaftuan shumë prej fiseve të Turkistanit.

Kalifi Mu'tesim u bëri vend më vonë dhe turqve si ushtarë në ushtrinë e tij, kështu që në përhapjen e fesë islame në rajonet e Uzbekistanit patën kontribuar dhe myslimanët të tjerë joarabë, si turqit selçukë dhe mongolët. Kjo ndodhi gjatë sundimit të tyre në viset e Uzbekistanit të sotëm, dhe pati ndikuar në përhapjen më të madhe të Islamit në vend.



transparentë, e udhëzues për umetin dhe prijësat e tij.

- Korrigjimi i koncepteve të gabuara, mbrojtja e umetit nga paqartësitë që të çojnë në humbje nëpërmjet përhapjes së dijes së saktë, e cila buron nga bazat e Islamit, sipas udhëzimeve që lanë dijetarët e hershëm islamë, duke qenë larg deformimit të ekstremistëve, pretendimeve të kota, dhe interpretimit të të paditurve.

- Bashkëpunimi në rrugët e bashkimit, të ngritjes së qëndrueshmërisë, dakortësia në çështjet e përgjithshme parimore, respektimi i mendimit ndryshe, dhe të pasurit kujdes nga rrymat e tekfirizmit me nxjerrjen e njerëzve nga feja, duke i konsideruar të shthurur apo të devijuar në çështjet ku ekziston ixhtihadi (mendimi i lirë në verdikte dhe në opinionet e dijetarëve), në mënyrë që të ruhen interesat e larta të umetit.

- Forcimi i koordinimit mes institucioneve fetare për dhënien e fetvasë, përgatitja për përbashkimin e fatkeqësive të përbashkëta nëpërmjet fetvave kolektive në interes të të gjithëve, dhe bërja kujdes nga fetvatë e përjashtuara individuale.

- Forcimi i komunikimit me rininë, ngushtimi i hendeqeve midis tyre, zgjerimi i horizonteve të diskutimit, sqarimi i tyre në gjërat e paqarta, dhe përpjekja për forcimin e rrugës së mesme që duhet të ndjekin.

Mesazhi i tretë

Ftesa e mjeteve të informimit të botës islame te:

- Forcimi i unitetit fetar dhe kombëtar në shoqëritë islame, dhe pengimi apo zmbarsja e thirrjeve që çojnë në destabilitet dhe sektarizëm.

- Ngulitja e vlerave dhe moralit islam, dhe parandalimi i antivlerave e fenomeneve negative, që bien ndesh me fenë islame.

- Përpjekja për të arritur besueshmërinë e informacionit duke e vërtetuar atë e duke përcjellë qëllimin e qartë, dhe parandalimi i promovimit të terrorizmit nëpërmjet përcjelljes së mesazheve të tij, si dhe arritja e njohjes së rëndësisë së madhe që ka përcjellja e mesazhit mediatik në botë.

- Puna sistematike për të kuruar sëmundjet e umetit, marrja e përgjegjësive, mospërhapja e mendimeve anormale dhe të dëmshme, aktivizimi i mjeteve të informimit për përhapjen e vetëdijes mbi ndalimin e gjakderdhjes, mbi rrezikun e padrejtësive, dhe parandalimi i përpjekjeve për ta shpërfytyruar imazhin e Islamit.

Mesazhi i katërt

Ftesa e rinisë islame te:

- Kapja fort pas Librit të Allahut dhe sunetit të Profetit (alejhisalatu uesselam) sipas rrugës që lanë të parët tanë të mirë në tre shekujt fatlumë, duke u larguar nga fitnet (çrregullimet) dhe shtigjet që të çojnë në përçarje dhe konflikte, distancimi nga teprimi në fe apo mangësia në të, respektimi i të drejtave të pacenueshme, ruajtja e jetës së tjetrit dhe përkujdesi për interesat madhore të umetit.

- Besueshmëria te dija dhe puna e dijetarëve të drejtë edukues, kthimi i tyre në referencë, ndjekja e gjyqimeve të tyre në fe, dhe të bërit kujdes nga pretenduesit e ndryshëm dhe guximi i tyre për të dhënë fetva në çështjet e rëndësishme të umetit.

- Kuptimi i fesë siç duhet, ngulitja e besimit në zemër, praktikimi i mirë i

- Ekstremizmi është tashmë fenomen botëror. Ai nuk ka fe, dhe as shtet të caktuar. Të akuzuarit e fesë islame me të është padrejtësi dhe shpifje, të cilat i hedhin poshtë argumentet e qarta kur'anore të zbritura nga Zoti i botëve.

- Ekstremizmi jofetar është shkak i kryesor i terrorizmit, sepse ai shkakton dhunën reaguese.

- Vlerat njerëzore janë natyrshëm vlera të përbashkëta, të cilat nuk pranojnë falsifikime që i nxjerrin ato nga përmbajtja e tyre.

- Lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit fetar nuk duhet të nënkuptojë konfliktin me fenë islame dhe promovimin e islamofobisë, por duhet të lërë për të kuptuar bashkëpunimin mes vetë shteteve muslimane, institucioneve të tyre, e dijetarëve.

- Liria, bashkë me parimet e saj,

- Toleranca mes popujve pa marrë parasysh mangësitë dhe gabimet e ndryshme që kanë ndodhur përgjatë historisë, pa nënçmuar të drejtat dhe pa harruar përvojat e mira dhe mësimet pozitive.

- Realizimi i shpejtë i drejtësisë është një përparësi e domosdoshme, duke unifikuar standardet dhe duke pasur qëndrueshmëri të balancuar.

Le të bashkëpunojmë në gjërat për të cilat biem dakort si pasojë e qytetërimit njerëzor, dhe të shmangim cenimin e njëri-tjetrit!

Le të zhdukim armiqtë dhe padrejtësitë që vazhdojnë të ndodhin, të largojmë pushtimin dhe sundimin e tij, t'u rikthejmë të zotërve të tyre të drejtat e cenuara dhe të uzurpuara, dhe le të jemi në nivelin e nderit dhe dinjitetit njerëzor që na ka dhuruar Allahu, Zoti i botëve!

Le të meditojmë së bashku mbi këto dy versete kur'anore, ku Allahu i Lartësuar thotë:

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i gjithëdijshëm, dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.” (Surja el-Huxhurat, ajeti 13)

“Thuaj: ‘O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: Se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim), dhe se njëri-tjetrin nuk do ta mbajmë për zot, në vend të Allahut!’ Nëse nuk pranojnë, atëherë thuaju: ‘Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!’” (Surja Ali Imran, ajeti 64)

Mëshira e Zotit dhe bekimet e Tij qofshin mbi Profetin tonë të dashur, Muhamedin (alejhisalatu usselam), familjen dhe të gjithë shokët e vet.

Kjo deklaratë është lëshuar në Mekën e nderuar.

Nga punimet e zhvilluara në Konferencën Ndërkombëtare Islame, “Islami dhe lufta kundër terrorizmit”, më 25 shkurt 2015.



fesë, vëmendja e duhur për të realizuar qëllimet, duke peshuar mirë dëmet dhe dobitë, dhe mosmashtimi nga disa slogane që shfaqen e që i përdorin qarqe të caktuara pa u mbështetur siç duhet në Kur'an dhe në Sunet.

- Të qenët racional në pasionet dhe entuziazmin e çastit, duke patur parasysh vlerësimin e çështjeve në parim, bërja vend përparësive dhe njohjes së realitetit, duke bërë durim në përshkallëzimin e punëve deri në arritjen e qëllimeve, duke pasur në vëmendje ligjet e Zotit në ndryshimin e gjendjes, duke ndjekur rrugët e ligjshme, dhe duke nxjerrë gjithashtu mësim nga përvojat e kaluara.

Mesazhi i pestë

Informimi i botës mbarë, i institucioneve dhe popujve, me çka vijon:

janë një vlerë që vetë Islami i ka dhënë shumë rëndësi, duke e lidhur me vlerën e përgjegjësive. Kësisoj, liria nuk mund të jetë një justifikim për të abuzuar me njerëzit, apo për të shkelur simbolet e shenjtat fetare.

- Ne jetojmë bashkë në një botë të përbashkët, ku bashkëjetojnë dhe shoqëritë me njëra-tjetrën, të cilat ndikohen në mënyrë reciproke, gjë e cila sjell domosdoshmërisht partneritet për ndërtimin e qytetërimit njerëzor dhe realizimin e interesave të përbashkëta.

- Komunikimi dhe debati mes njerëzve, i cili çon në njohjen midis tyre, është një domosdoshmëri njerëzore, duke mos u ngritur njëra palë mbi tjetrën, dhe duke mos e rrezikuar palën tjetër nga asimilimi.

Ateistët e rinj, vendparkimi dhe një vrasje

nga Ibrahim Kallën

Më 12 shkurt, Craig Stephen Hicks-i, një i bardhë dhe i vetëpërshkruar ateist, vrau në mënyrë brutale Deah Barakat-in, 23 vjeç, Yusor Abu-Salha-në, 21 vjeç, dhe Razan Abu-Salha-në, 19 vjeç, që të tre studentë muslimanë në Universitetin e Karolinës së Veriut në Chapel Hill. Hicks-i u dorëzua pas vrasjes me "stil ekzekutimi". Është në vijim një hetim, por të gjithë treguesit, siç bëhet e qartë nga deklaratimet dhe postimet e Hicks-it në rrjetin e internetit, bëjnë me dije për një krim për shkak të urrejtjes kundër muslimanëve. Pjesa më e madhe e organeve mediatike amerikane e raportuan fillimisht ngjarjen si vrasje të zakonshme. Qarkulloi historia e një grindjeje për vendparkimin për ta zvogëluar ndikimin e krimit. Zyrtarët nuk bënë asnjë deklaratë për tre ditë me radhë. Nuk pati asnjë mbulim të zgjeruar të ngjarjes, apo ndonjë analizë të qenësishme mbi shkaqet dhe pasojat e saj.

Në kundërpërgjigje, qytetarë, grupe të drejtave civile, udhëheqës bashkësish dhe përdorues të medias sociale ngritën shqetësimin mbi atë çka dukej të qe një heshtje e qëllimshme për incidentin e tmerrshëm. Shumë njerëz i kritikuan organet kryesore mediatike për shpërfilljen apo nënvlerësimin e vrasjes. Një pjesë e mirë ngritën pyetjen nëse reagimi zyrtar dhe publik do të kishte qenë i njëjtë sikur viktimat të ishin hebrenj apo kristianë të bardhë. Pa dyshim që do të kishte qenë ndryshe! Po qe se vrasësi do të ishte musliman dhe viktimat të ishin hebrenj apo krishterë, ne

do të kishim parë mbulimin minutë pas minute të ngjarjes, tërë hollësitë e skenës së krimit, identitetin e vrasësit, motivet, historinë familjare, fenë, librat e lexuar, postimet në Twitter dhe në Facebook, e kështu me radhë. Ekspertët e të ashtuquajturit terrorizëm do ta kishin ndarë "urtësinë" e tyre me botën mbi atë se si ky nuk ishte një incident i izoluar, por pjesë e një rrjeti në rritje radikalësh që synojnë të shkatërojnë qytetërimin perëndimor. Do të ishte identifikuar si incident terrorist përpara nxjerrjes së njoftimeve zyrtare. Por jo! Fjala terrorizëm nuk u përdor madje për të përshkruar vrasjen me stil ekzekutimi të tre studentëve muslimanë. Nuk pati praktikisht asnjë diskutim mbi identitetin apo historinë e vrasësit, me përjashtim të një numri të vogël deklaratash pëstjelluese nga anëtarët e familjes dhe ish-bashkëshortja e tij. Historisë së vendparkimit iu dha më shumë besueshmëri se motivit të krimit për shkak të urrejtjes, me gjithë faktin se Hicks-i thoshte në faqen e tij në Facebook se, "Kur vjen puna te fyerjet, feja juaj (Islami) e nisi këtë, jo unë. Nëse feja juaj e mban mbyllur gojën e saj të madhe, kështu do bëj dhe unë." Askush nuk pyeti pse një ateist i vetëdeklaruar do të fyhej nga Islami në veçanti për asnjë arsye tjetër veç urrejtjes së tij për të gjitha fetë. Ç'ka ndryshe Islami për "ateistët e rinj"?

Kjo është pika ku Hicks-i kthehet nga literatura fshikulluese antiislame dhe antimuslimane prej ateistëve të tillë të rinj si Richard Dawkins, Christopher Hitchens dhe Sam Harris. Të maskuar

si ateistë racionalistë dhe shkencorë, sulmet e tyre mbi Islamin janë midis komenteve më të shtrembëruara, më të mbushura me urrejtje dhe më raciste që mund të gjeni mbi ndonjë fe apo grup. Ajo literaturë është më militante dhe më agresive se goditja neonaziste dhe e së djathtës ndaj Islamit. Ajo mbron fanatizmin dhe urrejtjen antiislame në emër të arsyes dhe shkencës. Siç vë në dukje Werleman-i, ateistët janë distancuar tashmë nga ky grup. Ata besojnë se Dokins-i, Hitchens-i, Harris-i, e të ngjashmit me ta, e përligjin racizmin dhe diskriminimin e individëve muslimanë, dhe kjo nuk ka të bëjë aspak me ateizmin e vjetër. Ideologjia e tyre fanatike është e karakterizuar nga "antiteizmi", pra, jo vetëm nga hedhja poshtë e fesë, por nga luftimi në mënyrë militante kundër atyre që kanë një besim fetar. Sido që urrejtja e tyre ngjan të jetë drejtuar ndaj Islamit dhe muslimanëve më shumë se ndaj çdo feje tjetër. Ata e denoncojnë dhe e demonizojnë Islamin mbi baza ideologjike dhe politike, duke i shërbyer një axhende qartësisht të ngushtë politike. Kjo është arsyeja pse Chomsky, vetë një ateist, vë në diskutim motivet politike të ateistëve të rinj dhe u kërkon atyre të shohin në pasqyrë.

Unë personalisht nuk kam problem me një debat serioz intelektual mbi Islamin, Krishterimin ose Judaizmin, dhe kritikave të bëra ndaj tyre. Por duhet përcaktuar vija ndarëse ku kritika bëhet fyerje, e ku fyerja kthehet në urrejtje dhe dhunë. Raste të shumta vënë në pah lidhjen tejet të rrezikshme midis ligjërimit të urrejtjes islamofobike

dhe dhunës.

Një nga shembujt e qartë që tregojnë lidhjen midis literaturës islamofobike dhe dhunës është Anders Breivik, i cili më 22 korrik 2011 hodhi lëndë plasëse në ndërtesat qeveritare në Oslo, duke vrarë tetë njerëz. Breivik e vazhdoi kasaphanën e tij në ishullin e Utoyës, dhe vrau 69 të rinj, një nga një. Manifesti i tij prej 1500 faqesh, i quajtur, "2083: Një deklaratë europiane e pavarësisë", zbulon thellësinë e frikshme të racizmit dhe urrejtjes ndaj Islamit. Manifesti i tij është i mbushur me citime dhe referenca nga ato çka pranohen si sulme të linjës së përgjithshme mbi Islamin dhe muslimanët në shkrimet e islamofobëve amerikanë dhe evropianë. Nga grupi PEGIDA në Gjermani te Kur'ani që djegin pastorët në SHBA, grupet e urrejtjes antimuslimane e shfrytëzojnë këtë literaturë për të përligjur racizmin dhe fanatizmin e qartë.

Neni i 20-të i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike ka vënë tanimë caqe për format e fjalës që mbrojnë "urrejtjen kombëtare, racore apo fetare, që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë". Shumë konventa të tjera ndërkombëtare e dënojnë dhe e ndalojnë fjalën e urrejtjes si krim urrejtjeje. E keqja është se ky parim vështirë të vihet në zbatim për rastet e fjalës së urrejtjes antimuslimane.

*Përzgjedhi dhe përktheu:
Bujar M. Hoxha*



Prindërit muslimanë amerikanë dhe çështja e ndërlikuar e arsimit

Mahasin D. Shamsid-Deen

Shumë prindër muslimanë në SHBA luten nga zemra për udhëzimin sesa t'ia dalin sfidës së vendosjes mbi arsimimin e fëmijëve të tyre. Serioziteti i pasjes së një qasjeje për edukimin dhe rritjen brenda familjes që priret për nga më e mira për këtë jetë dhe për tjetrën për pasardhësit e tyre e bën zgjedhjen e arsimit të vështirë dhe të marrë jo lehtë.

Vendimi bëhet akoma më i ndërlikuar nga fakti se shpesh nuk është i udhëhequr vetëm nga besimi i thellë fetar, por gjithashtu nga faktorët sociopolitikë. Kjo vlen qoftë kur prindi ka lindur dhe është rritur në Amerikë, qoftë kur ka emigruar për në SHBA dhe ka përqafuar identitetin dhe kulturën e saj.

Dëshira për ta ndihmuar psikikën e fëmijës së tyre të zhvillohet duke i siguruar një mjedis pa ndikime që bien në kundërshti me parimet dhe besimin islam është e barazpeshuar për shumë prindër muslimanë me dëshirën për të siguruar një arsimim që është i dobishëm dhe konkurrues me botën rreth tyre.

Prindërit muslimanë që kanë emigruar për në SHBA janë në pjesën dërmuese nga vende më pak të zhvilluara, qoftë të botës së dytë apo të tretë. Muslimanët e lindur në SHBA janë përgjithësisht pakica etnike brenda Amerikës. Përfundimi është se as njëra palë e as tjetra nuk janë pjesë e shoqërisë më të madhe amerikane, dhe kështu do të kenë një epërsi kulturore dhe historike për të kuptuar realitetin negativ të arsimit nën standardin.

Shkolla islame apo publike?

Kësisoj, prindërit janë përballur me dy zgjedhje: ose t'i fusin fëmijët në një shkollë të bazuar në Islamin, ose jo. Kur zgjidhet një përvojë e një shkolle të bazuar në Islamin, kjo mund të përfshijë mësimin në shtëpi; një shkollë me kohë të plotë të drejtuar nga muslimanët, me synimin për të ofruar një medhheb të veçantë të besimit islam si pjesë të programit mësimor apo të një mësimi fetar në fundjavë. Çdonjëra prej këtyre zgjedhjeve ka të mira e të këqija.

Prindërit që zgjedhin mësimin në shtëpi mund të mos kenë njohuritë, prirjen, apo madje durimin për t'u dhënë dije në çdo aspekt fëmijëve të tyre. Ata të cilët zgjedhin një përvojë fetare me kohë të plotë ose në fundjavë ndeshen shpesh me mësues pa eksperiencë, me të dhëna të tepruara në mënyrë të gënjeshtërt, me metodologji mësimdhënieje mospajtuëse,

me burime kapitale të kufizuara, e me politika eksperimentale, që absolutisht e komprometojnë arsimimin e fëmijës së tyre.

Në anën tjetër, prindërit që i fusin fëmijët në shkolla amerikane alternative, publike apo të drejtuara privatisht, mund të përballen me racizëm, diskriminim, paragjykim të studentëve, mësuesve apo sistemit shkollor, me politika e programe mësimore që bien ndesh me besimin dhe vlerat e tyre, e me fuqi ekonomike ose politike të kufizuar për të bërë ndryshme. E të tëra këto e komprometojnë po ashtu absolutisht arsimimin e fëmijës së tyre.

Në këtë mënyrë, zgjedhja e një përvojë shkollore për fëmijët e tyre, me dëshirën për t'iu përmbajtur urdhrin të Allahut, më të lartit, në Kur'anin e shenjtë, në suren 66, ajeti 6, nuk është aspak e lehtë.

Psika dhe gjendja njerëzore është e ndërlikuar. Edhe qëllimet më të mira e sinqeriteti i vendimeve për futjen e fëmijëve muslimanë në alternativat shkollore janë të udhëhequra nga një komponent sociopolitik. Nga pikëpamja kulturore, prindërit muslimanë në SHBA ndeshen me një presion shoqëror nga brenda bashkësisë muslimane për t'i futur fëmijët në shkollat e administruara prej muslimanëve. Unë besoj se kjo e ka bazën në dëshirën e sinqertë dhe në kërkesën që muslimanët të krijojnë jetë komuniteti, dhe kjo është e lidhur sigurisht me fëmijët. Allahu na urdhëron në Kur'anin e shenjtë të hyjmë plotësisht në Islam. Që gjendja njerëzore të jetë e plotë, ajo ka të bëjë më tepër se thjesht me mua si individ, e përfshin gjithashtu gjendjen e familjes dhe të bashkësisë time. Jetët tona nuk janë të ndara nga ato të bashkëbesimtarëve tanë; interesat e bashkësisë së tërë kanë ndikim mbi të gjithë ne. Kështu, ne agjerojmë gjatë ramazanit vetë, si individë, ndërsa e gjithë bota e muslimanëve në botë agjëron me ne, dhe ne i kryejmë ritet e haxhit vetë, si individë, por në një det njerëzic.

O ju që keni besuar, hyni në Islam plotësisht [dhe përsosurisht], dhe mos ndiqni gjurmët e djallit. Në të vërtetë, ai është për ju armik i hapur. (Surja el-Bekare, ajeti 208)

Prandaj, ndërsa përpiqemi ta përqafojmë plotësisht Islamin, përvoja e ndarë e bashkësisë është pjesë e rrugës sonë si muslimanë. Që këtej, ka një qortim pa zhurmë të prindërve që marrin vendimin për të mos i futur fëmijët në shkollat pranë të administruara nga muslimanët, pavarësisht sa i vlefshëm

mund të jetë arsyetimi i tyre – largësia, arsyet ekonomike, niveli i mësuesve – sepse mungesa e mbështetjes së përpjekjes është parë si një akt fyes për krijimin e jetës së plotë të komunitetit.

Ndërsa ekziston ky presion shoqëror i pazë, ka gjëra që nuk shkojnë. Disa shkolla janë relativisht pa përvojë, me personel e burime të kufizuara. Më ligështuese janë dhe dallimet raciale e etnike, të shfaqura herë-herë.

Si rrjedhim, veç zgjedhjes së një shkolle të administruar nga muslimanë që përpiqen të japin mësim një program mësimor të mbështetur në Islamin, prindërit duhet të zgjedhin nëse duhet t'u qëndrojnë apo jo besnikë lidhjeve etnike, politike dhe kulturore. Vëzhgimi im personal është se muslimanët vendas amerikanë do t'i kapërcejnë vijat ndarëse etnike në një përqindje më të madhe se muslimanët që kanë emigruar për në SHBA.

Besim, kulturë dhe etnicitet...

Një shkollë me program mësimor me bazë islame u hap në një qytet nga një grup muslimanësh amerikano-afrikanë, çdonjëri me më shumë se njëzet e pesë vite përvojë arsimore, me doktoratura, me kërkime të botuara e të njohura në botën akademike, e me akreditim nga autoritetet qeverisëse arsimore të SHBA-së; të tërë ata ishin ndeshur me shpërfillje të plotë nga zonat ku prindërit muslimanë nuk janë të të njëjtit grup etnik.

Këto lloj pengesash të problematikave të dukshme por të shmangura nga diskutimi kontribuojnë që prindërit të mos zgjedhin përvojën e “shkollës muslimane”, dhe t'i fusin fëmijët në institucione shkollore publike dhe private. Ca nga ata janë amerikanë nga pikëpamja kulturore, dhe besojnë se politika e “përfshirjes” dhe vlerësimi për “diversitetin” që shkollat amerikane supozohet të ndjekin proceduralisht i mbrojnë fëmijët e tyre prej indoktrinimit të dukshëm fetar.

Prindërit që kanë emigruar për në SHBA kërkojnë në mënyrë të qëllimshme të asimilohen brenda shoqërisë, dhe i zgjedhin këto alternativa arsimore për fëmijët e tyre si pjesë e këtij procesi asimilimi. Të tjerë prindër muslimanë thjesht nuk kanë alternativë praktike afër shtëpive të tyre, apo të ardhura të mjaftueshme, dhe prandaj i dërgojnë fëmijët në shkollat publike a private amerikane.

Për çfarëdo arsye që prindërit muslimanë zgjedhin këtë alternativë arsimore, ata do të hyjnë në dy kategori: ose do të pajtohen me politikat që

ka shkolla dhe do të mbajnë një komunikim të hapur me fëmijët, për t'i interpretuar ato gjëra që nuk janë në përputhje me kulturën e tyre familjare apo fetare, ose do të përfshihen politikisht.

Prindërit që zgjedhin t'u përmbahen procedurave të shkollës nuk kërkojnë shpesh të bëjnë ndryshim sistemor, por në vend të kësaj vendosin t'u drejtohen mësuesve të veçantë për përshatje për fëmijët e tyre. Kjo mund të jetë nga diçka e shkruar që kërkon që fëmija të mos bëhet pjesë e një aktiviteti feste a pushimi, te një kërkesë për ta njohur klasën me festën e Bajramit. Prindërit të tjerë thjesht i shpërfillojnë të gjitha çështjet shkollore dhe i dërgojnë fëmijët e tyre me idenë e mosbërjes apo mosthënies asgjë të veçantë për politikat ose procedurat e shkollës.

Këta prindër muslimanë që zgjedhin të përfshihen politikisht i bashkohen shoqatës prindër-mësues, dhe i përcjellin shqetësimet e tyre te bordi i shkollës, e mund të përfshijnë gjithçka, nga përcaktimi i prodhimeve me mish derri në listën e gjellëve të drekës, te edukimi fizik i reduktuar gjatë ramazanit, dhe te modifikimi i normave të kodit të veshjes për t'u lënë hapësirë shamive të kokës për vajza. Baballarë të tillë punojnë për përgatitjen e ndjeshmërisë së mësuesve dhe përfshirjen e festave muslimane në kalendaret shkollore. Por shpesh ata hasin rezistencë, armiqësi dhe racizëm nga shoqëria më e madhe.

Kështu, nuk ka zgjedhje të lehta arsimore për prindërit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Prindërit muslimanë duhet të bëjnë lutjen e istihares për ndihmë në udhëzimin në rrethanat e dhëna, e të besojnë se zgjedhja e tyre është e dobishme për bijtë dhe e pëlqyeshme për Allahun.

*Përzgjedhi dhe përktheu:
Bujar M. Hoxha*

Islami është pjesë e pandashme e Europës

Përgatiti: Emërim Koçi

Në këtë hulumtim sociologjik dhe demografik s'duhet të harrojmë se Europa nuk njihet me Islamin vetëm gjatë kohëve të fundit, por Islami është pjesë e pandashme e Europës.

Europa dhe Islami kanë lidhje të ngushta shekullore me njëri-tjetrin. Së pari, shteti i Andaluzisë në Gadishullin Iberik, dhe më vonë kryqëzatat e përhapja e kalifatit osman, sollën marrëdhënie të ndërsjellta mes dy shoqërive. Shumë historianë dhe sociologë e shohin sot Islamin si shkaku kryesor të daljes së Europës nga errësira e Mesjetës në shkëlqimin e zhvillimit modern. Në një kohë kur Europa ishte e prapambetur në mjekësi, astronomi, matematikë, e në fusha të tjera, muslimanët kishin një thesar të madh njohurish dhe mundësi të mëdha zhvillimi, njohuri të cilave ajo iu referua.

Ashtu si në vende të tjera, Islami është në rritje të shpejtë edhe në Europë. Ky zhvillim ka tërhequr vëmendjen më tepër në vitet e fundit, siç dëshmohet prej shumë temave, raporteve dhe artikujve, "mbi vendin e Islamit në Europë" dhe "mbi dialogun mes shoqërisë europiane dhe asaj islame". Rrënjët e këtij interesimi gjenden në rritjen e vazhdueshme të popullatës muslimane, jo vetëm për shkak të emigrimit. Përpos emigracionit, që ka patur një rol të rëndësishëm në shtimin e popullatës muslimane, shumë hulumtues kanë theksuar një arsye krejt

tjetër: përqindjen e lartë të kthimit në muslimanë, sipas një raporti perëndimor të viteve të fundit. Ky raport deklaroi se numri i atyre që po kthehen në Islam në shtetet perëndimore është rritur edhe më tepër, veçanërisht pas sulmeve të 11 shtatorit. Për shembull, numri i të kthyerve në Islam në disa shtete kryesore të Europës u rrit vitet e fundit nga 30.000 deri në 50.000.

Disa lajme shumë të gëzueshme për një të ardhme tepër të pritur

Me mbledhjen e tërë këtyre fakteve arrijmë në përfundimin se Islami po ngjall gjithmonë e më tepër interes në botë. Këto zhvillime lënë për të kuptuar se bota po shkon drejt një epoke të re, ku dashtë Zotit, Islami do të zërë vend të rëndësishëm, dhe mësimet e etikës në Kur'an dhe në traditën profetike do të përhapen masivisht. Është me rëndësi të vihet në dukje se ky zhvillim shumë i rëndësishëm është përmendur në Kur'an para 14 shekujve, ku Allahu i Lartësuar thotë: "Ata duan ta shuajnë Dritën e Allahut me gojët e tyre, por Allahu nuk do ta lejojë këtë, përkundrazi, Ai do ta përsosë Dritën e Tij, edhe pse këtë e urrejnë mohuesit (jobesimtarët). Është Ai që e ka sjellë të Dërguarin e Tij me udhëzime dhe me fenë e vërtetë, për ta ngadhënjyer përmbi të gjitha fetë, edhe pse politestët e urrejnë." (Surja et-Tevbe, ajetet 32-33)

Përhapja e moralit islam është një nga premtimet e Zotit ndaj besimtarëve.


Veç këtyre ajeteve, ka shumë thënie të Pejgamberit tonë, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, që pohojnë se mësimet e Kur'anit dhe të traditës profetike kanë për të triumfuar. Pejgamberi, alejhi selam, thotë: "Në kohën e fundit, para mbarimit të kësaj bote, njerëzimi do të përjetojë një periudhë në të cilën keqberja, padrejtësia, mashtrimi, dredhia, grindja, konflikti dhe degjenerimi moral do të jenë shumë të përhapura. Pastaj do të vijë periudha e artë, në të cilën morali i mirë ka për të qenë i pranishëm tek njerëzit në tërë botën."

Disa nga këto thënie do t'i përmendim më poshtë së bashku me komentimin e tyre.

"Gjatë kësaj periudhe ummeti im do të bëjë jetë të rehatshme dhe pa brengë, të cilën nuk e ka përjetuar asnjëherë më parë. Toka do ta nxjerrë prodhimin e vet pa ndalur asgjë, dhe pasuria do të ekzistojë me bollëk në atë kohë." (Transmeton Ibn Maxhe në Sunenin e tij) "Banorët e qiejve dhe të tokës do të jenë të kënaqur. Toka do të nxjerrë gjithë atë që rritet në të, dhe qielli do të lëshojë shi me bollëk. Për shkak të këtyre të mirave të gjallët do të dëshirojnë që të vdekurit të kthehen në jetë përsëri." (Muhtesar Tedhkire Kurtubi fq. 437) "Toka do të mbushet me barazi dhe drejtësi, siç qe mbushur më parë më shtypje dhe tirani." (Transmeton Ebu Davudi) "Drejtësia do të mbizotërojë deri në atë masë sa që çdo pronë e marrë me dhunë

do t'i kthehet pronarit të saj; për më tepër, sendi që është marrë nga dikush do të kthehet edhe nëse gjendet nën dhembët e marrësit. Bota do të jetë plot siguri, sa që disa gra do të mund ta kryejnë haxhin pa shoqërimin e burrave." (Ibn Haxher Hejthem, Al-Qaul Muhtasar, fq. 23)

Duke u mbështetur në këto thënie, periudha e artë do të jetë një kohë në të cilën mes njerëzimit ka për të ekzistuar drejtësia, bollëku, mirëqenia, siguria, paqja dhe vëllazërimi, një kohë ku njerëzit do të përjetojnë dashuri, vetë-sakrificë, tolerancë, kujdes, mëshirë dhe lumturi. Në fjalët e tij, Pejgamberi ynë, Muhammedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, thotë se kjo kohë e bekuar ka për t'u përjetuar me ardhjen e Mehdiut, i cili do të vijë në kohën e fundit për ta shpëtuar botën nga kaosi, padrejtësia dhe rënia e moralit. Ai do t'i shkatërrojë ideologjitë jofetare, dhe do ta ndalojë padrejtësinë që mbizotëron. Për më tepër, ai do të bëjë që mësimet e Kur'anit dhe tradita profetike të përhapen midis njerëzimit, e ka për të sjellë paqe dhe mirëqenie në botë. Ngritja dhe përhapja e Islamit që po ndihet tani, si dhe roli i muslimanëve në epokën e re, janë shenja se periudha e paralajmëruar në Kur'an dhe Hadith është shumë pranë.



Xhamia Al Hambra në Spanjë

Bar Restorant Piceri "Ishulli Luanëve"

Në dalje të Tiranës, larg zhurmave të përditshme, në qetësinë dhe në ajrin e pastër, do të shijoni gatime tradicionale dhe hallall të guzhinës sonë.

Menu e pasur dhe një pamje piktoreske e lumit Erzen, e cila do t'ju mahnisë.

Ju mirëpresim!



Adresa: Rruga nacionale
Tiranë-Durrës, Ndroq, km 17

Mobile: 00355 682153105

PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë
xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë
Cel: 0672812607 / 0672821589

Produkte të firmës "Phenomenal", vaj të farës së zezë
Mjaltë me polen, mjaltë sidri, etj.
Hurra arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe vajra bimore "Tact"
Shampo bimore "Touch Me" nga Tajlanda
Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojlojshme
Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar
Kohël bimor për sytë etj.

www.produktenatyrale.com
Email: agimballa@hotmail.com

